

VENDIM
Nr. 113, datë 15.2.2012

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2012, PËR AUTORITETIN E
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 117 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2012, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, në shumën 266 000 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë) lekë, të ndarë sipas zërave, të paraqitura në lidhjen nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha